

Data __. __. 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje mobilje për zyrat e ASDC

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mobilje – 39100000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,850,000 (tre milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albanian Seaports Development Company ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, nuk duhet të jetë më e vogël se 40% e vlerës përlogaritur të fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.1 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më pak se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime për realizim të suksesshem të kontratës të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi. kontratën pa vonesa dhe pengesa që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.2 Operatorët ekonomik duhet të kenë një punësim mesatar mujor prej të paktën 7 (shtatë) punonjësve gjatë 6 mujorit të fundit, nga data e zhvillimit të kësaj procedure, të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj,
- List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për secilin muaj.

Argumentimi: Ky kriter është i nevojshëm që Operatorët pjesmarrës të provojnë besueshmërinë dhe provojën e tyre në realizimin e kontratës pa vonesa dhe pengesa, që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qira të paktën 2 (dy) automjete për transport mallrash me kapacitet mbi një ton, për dergimin e mallrave sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është i nevojshëm që Operatorët pjesmarrës të provojnë besueshmërinë dhe provojën e tyre në realizimin e kontratës pa vonesa dhe pengesa, që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat të përshtatshme ose ekuivalentet e tyre për objektin e prokurimit si më poshtë:

- ✓ ISO 9001-2015 është e nevojshme për garantimin e cilësisë së produkteve apo shërbimeve në mënyrë të qëndrueshme.
- ✓ ISO 14001:2015 Certifikata e menaxhimit të cilësisë së mjedisit e kërkuar nga AK garanton se OE ofertuesi do të sjellë produkte të cilat nuk dëmtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë dhe që janë konform standardeve ndërkombëtare të mjedisit.
- ✓ ISO 45001-2018 Çertifikim për menaxhimin e cilësisë e kërkuar nga AK garanton se OE ofertues do të sjellë produkte që janë konform standardeve ndërkombëtare të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatat e mësipërme. Ky kriter është e lidhur ngushtësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në përpjestim me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe duhet të jenë të lëshuara nga autoritetet kompetente, në mënyrë që të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

4.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat të përshatshme ose ekuivalentet e tyre për objektin e prokurimit si më poshtë:

- *Kolltuk EN 12520 - 2016* ose ekuivalente SSH/EN
- *Karrike zyre EN 1335-1:2020* ose ekuivalente me SSH
- *Tavolinë zyre EN 527-1:2016+A1:2019* ose ekuivalente me SSH
- *Etazher me kapak për zyra EN 14073-2:2008* ose ekuivalente me SSH

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Kolltuk EN 12520 - 2016 ose ekuivalente SSH/EN, është një standart i nevojshëm për të garantuar qëndrueshmërinë e ulëseve, fortësinë e tyre.

- *Karrike zyre EN 1335-1:2020*, ose ekuivalente me SSH

EN 1335-1:2020 është një standart i vlefshëm për karriget e tavolinës së zyrës. Ky standard përcakton dimensionet e tre llojeve të karrigeve dhe metodat e provës për përcaktimin e tyre.

- *Tavolinë zyre EN 527-1:2016+A1:2019* ose ekuivalente me SSH

EN 527-1:2016+A1:2019 është një standart i nevojshëm për të garantuar qëndrueshmërinë e tavolinave, fortësinë e tyre, duke marrë shkas nga sasia e lartë e mobiljeve të dëmtuara në magazinën e APD.

- *Etazher për zyra EN 14073-2:2008* ose ekuivalente me SSH

EN 14073-2:2008 Ky standart specifikon metodat e provës për përcaktimin e sigurisë së strukturës së mobiljeve të zyrës të cilat janë të pozicionuara vertikalisht, horizontalisht ose/dhe që mbështeten në mur, si dhe qëndrueshmërinë e mobiljeve të pozicionuara vertikalisht, horizontalisht ose/dhe që mbështeten në mur.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar objekt prokurimi kjo e vertetuar nepermjet dokumentave orgjinal si perfaqesues i kompanise prodhuese per mallin/mallrat zerat e percaktuara ne Dokumentat e Tenderit.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon/fax/e-mail/Website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

6. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave, në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

7. Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike te paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një tablele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;
 - a. Emri i kompanisë prodhuese ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit.Adresa dhe Web-site të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.
 - b. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.
 - c. Nr.i faqes në katalog referuar Nr.Idetifikues te artikullit të ofruar sipas listës i shenuar me nje shenje dalluse.

Shenim 1 Specifikimet teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, shoqëruar me deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, të firmosura dhe të vulosura nga ofertuesi nuk do të pranohen në cilësinë e Ofertës Teknike të kërkuar më sipër. Mos plotësimi i kësaj pikë do të sjellë pavleshmëri të ofertës.

Shenim 2 Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike të ofertuesit duhet të korespondojnë me të dhënat në Katalogë/Prospekte. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavleshmëri të ofertës.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, eshte vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

8. Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave duhet te paraqese mostra per zerat e percaktuara ne Dokumentat e Tenderit.

Argumentim: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të vlerësojë mallrat objekt procedure prokurimi nëse janë në përputhje me specifikimet teknike dhe gjykon se prezantimi i mostrave ka

rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kriteri i kërkuar në lidhje me paraqitjen e mostrave, është vendosur në përputhje me piken 6/a, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”